

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” NË MITROVICË

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Donika Latifi

Mitrovicë, 2024

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” NË MITROVICË

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

**RËNDËSIA E MOTIVIMIT TË NXËNËSVE NGA
ANA E MËSIMDHËNËSIT NË LËNDËN “GJUHË
SHQIPE” NË KOMUNËN E MITROVICËS**

Mentorja:

Ass. Fatbardha Hoxha

Kandidatja:

Donika Latifi

Mitrovicë, 2024

UNIVERSITY “ISA BOLETINI” IN MITROVICA
FACULTY OF EDUCATION



DIPLOMA THESIS

THE IMPORTANCE OF STUDENT MOTIVATION
BY THE TEACHER IN THE SUBJECT
“ALBANIAN LANGUAGE” IN THE
MUNICIPALITY OF MITROVICA

Mentor:

Ass. Fatbardha Hoxha

Candidate:

Donika Latifi

Mitrovicë, 2024

UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” NË MITROVICË

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Gjuhë shqipe I

Titulli i punimit: Rëndësia e motivimit të nxënësve nga ana e mësimeve në lëndën “Gjuhë shqipe” në Komunën e Mitrovicës.

Emri dhe mbiemri: Donika Latifi

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri): 1606011039

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentorja e punimit: Ass. Fatbardha Hoxha

Aprovuar prej komisionit:

1. _____, mentor

2. _____, anëtar

3. _____, anëtar

Data e aprovimit: _____

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se ky punim diplome me titull “Rëndësia e motivimit të nxënësve nga ana e mësimit në lëndën “Gjuhë shqipe” në Komunën e Mitrovicës.” është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Për të gjitha pjesët e marra janë të vendosura referencat dhe garantoj se këtë punim nuk e kam dorëzuar për t’u vlerësuar për ndonjë modul tjetër.

Donika Latifi

FALËNDERIM

Së pari, dua të falënderoj Zotin që më bekoi me forcën dhe aftësinë e nevojshme për të përfunduar këtë punim diplome. Tutje falënderoj të gjithë stafin akademik të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, të cilët më ndihmuan të rritesha në mënyrë akademike dhe profesionale. Me theks të veçantë falënderoj mentoren time, prof. Fatbardha Hoxha, për kontributin, këshillat dhe përkushtimin e saj maksimal në realizimin korrekt të këtij studimi. Për më tepër, unë do të doja të shprehë mirënjohjen dhe faleminderimin e pafund për përkrahjen dhe mbështetjen e familjes sime në secilin hap.

PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORSISË.....	V
FALEMINDERIMI.....	VI
LISTA E TABELAVE.....	IX
LISTA E FIGURAVE.....	X
Abstrakti.....	XI
Abstract.....	XII
1. HYRJE.....	1
1.1. Teoritë e motivimit	3
1.1.1. Teoria e pritshmërisë – vlerës	3
1.1.2. Teoria e njohjes kognitive.....	5
1.1.3. Teoria e vetëvendosjes.....	5
1.1.4. Teoria e interesit.....	6
1.1.5. Teoria e qëllimit të arritjes.....	8
1.1.6. Teoria e atribuimit.....	9
1.2. Klima motivuese në klasë.....	11
1.3. Roli i mësimdhënësit në motivimin e nxënësve.....	12
2. METODOLOGJIA.....	14
2.1. Pjesëmarrëasit.....	14
2.2. Instrumenti.....	14
2.3. Mënyra e mbledhjes së të dhënave.....	14
2.4. Analizat.....	14

2.5. Aspekti etik.....	15
2.6. Kufizimet e hulumtimit.....	15
3. REZULTATET	16
4. DISKUTIME	19
5. KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET.....	20
LITERATURA.....	21
SHTOJCAT.....	23
SHTOJCA A – FORMULAR PAJTIMI.....	23
SHTOJCA B – PYETJET KYÇE TË DISKUTIMIT.....	24

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Matrica e teorisë së qëllimit të arritjes

Tabela 2: Shembull – Një nxënës dështon në test dhe më pas reflekton mbi shkaqet e dështimit.

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1: Konstrukti i vlerës dhe i pritshmërisë

Figura 2: Modeli konceptual që tregon se si ndërhyrjet nxisin zhvillimin e interesit dhe rezultatet e mëvonshme arsimore

ABSTRAKTI

Motivimi i nxënësve është një nga faktorët thelbësor në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi i rolit të mësimdhënësit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe në Komunën e Mitrovicës. Mostra të hulumtimit janë gjashtë mësimdhënës/e të dy shkollave fillore të Komunës së Mitrovicës, njëra në qendër të qytetit dhe tjetra në fshatin Vaganicë, ku kemi të bëjmë me studim rasti.

Instrumenti i këtij punimi hulumtues ka qenë fokus – grupi, pyetjet janë pilotuar sipas standardit. Pyetjet që u realizuan kërkojnë përgjigje të hapur nga të intervistuarit, ku u realizuan gjithsej 9 pyetje. Pjesë e këtij hulumtimi janë mësimdhënësit/et e klasëve të pesta. Me instrumentin fokus – grup, të dhënat u përpunuan nëpërmjet mënyrës cilësore (kualitative) të studimit. Rezultatet që dolën nga ky hulumtim tregojnë që mësimdhënësit, së bashku me motivimin e brendshëm e të jashtëm, e poashtu me krijimin e një ambienti inkurajues dhe mbështetës luajnë një rol qenësor në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe.

Fjalët kyçe: motivimi, nxënësi, klasët e pesta, roli i mësimdhënësit

ABSTRACT

The purpose of this study is to investigate the role of the teacher in the motivation of students in the subject of the “Albanian Language” in the Municipality of Mitrovica. The research sample are six teachers from two different primary schools of the Municipality of Mitrovica, one in the city center and the other one in the village of Vaganica. The instrument of this research paper was the focus group, which was piloted by the researcher herself. The questions asked require open answers from the interviewees, a total of 9 questions were asked. The fifth grade teachers are part of this research. With the focus group instrument, the data were processed by means of a qualitative study. The results obtained from this research show that teachers, along with the internal and external motivation, as well as an encouraging and supportive environment, play an essential role in students motivation in the subject of Albanian language.

Key words: motivation, student, fifth grade, teachers’ role

1. HYRJJE

Koncepti i motivimit është disi i paqartë dhe i reziston përkufizimit të saktë. Megjithatë, në mënyrë të thjeshtë, motivimi merret me arsyen pse ndodh sjellja njerëzore. “Shumica e psikologëve dhe e edukatorëve përdorin motivimin si një fjalë për të përshkruar ato procese që mund: a) të zgjojnë dhe të nxisin sjellje; b) t’i japin drejtim dhe qëllim sjelljes; c) të lejojnë sjelljen të vazhdojë; dhe d) të drejtojnë te zgjedhja (lead to choosing) apo preferimi i një sjelle të caktuar (Wlodkowski, 1984). Thënë më ndryshe, forcat që veprojnë në apo përbrenda një personi për të nisur apo aktivizuar një sjellje quhet motivim. Fjala motivim rrjedh nga termi Latin *motivus* (“a moving cause, veprim”), që sygjeron aktivizimin e vetive të proceseve të përfshira në motivimin psikologjik (N.Cofer & L.Petri, 2023). Termi motivacion përshkruan “pse” një person bënë dicka. Është forca shtytëse mbrapa veprimeve njerëzore, është proces që inicon, drejton dhe shkakton sjellje të orientuara drejt qëllimit. Thënë më shkurtimisht motivimi na shkakton neve të veprojm në një mënyrë të caktuar për të arritur më afër qëllimeve tona.

Motivimi përfshinë forcat biologjike, emocionale, sociale dhe kognitive të cilat aktivizojnë sjelljen njerëzore (Cherry, 2023). Një ndër kushtet thelbësore të të mësuarit është motivimi. “Një gjendje motivuese mund të përkufizohet si një gjendje stimuluese e cila fillon apo inicon si dhe drejton veprimin derisa të hiqet” (McClelland, 1955, fq.424-425).

Qeniet njerëzore gjithmonë janë nën drejtimin e ndonjë nevoje apo motivi. Gjendja motivuese e tyre mund të jetë fiziologjike (uria, etja, pushimi) ose psikologjike (dëshira, ineteresi apo qëndrimi) (Ames, 1990). Sipas (Deci & Ryan, 1981) në thelb, njerëzit në cdo kohë mund të jenë në një nga tre gjendjet e ndryshme të motivimit: të motivuar nga ana e brendshme, të motivuar nga jashtë apo të pa motivuar. Sjelljet e motivuara nga ana e brendshme, bazohen në nevojën e lindur të njerëzve për të qenë kompetent dhe të vetëvendosur. Kur motivohemi në mënyrë të brendshme, ndjenjat dhe mendimet spontane që e shoqërojnë aktivitetin nuk kanë asnjë ndarje nga shpërblimi, pra duket se shpërblimi për aktivitetin është vet pjesë përbërse e tij. Kurioziteti, eksplorimi dhe loja janë disa nga shembujt e këtij motivi. Të mësuarit e vetëdrejtuar të fëmijëve të vegjël është një shembull i sjelljes së motivimit të brendshëm, meqenëse të mësuarit e tyre është aktiv, mendjehapur, përfshinë habinë dhe kuriozitetin, u siguron atyre mjetet për të qenë më të vetëvendosur si dhe i udhëheq ata drejt zotërimit të mjedisit të tyre (Deci & Ryan, 1981).

Në rastet kur ne motivohemi nga jashtë, atëherë ne punojmë drejt një shpërblimi të jashtëm – mund të jenë paratë, notat e mira, statusi, miratimi apo shmangia e një ngjarëje të pakëndëshme. Vëmendja jonë është pjesërisht e përqendruar më shumë në rezultatin e dëshiruar sesa në vetë aktivitetin, andaj priremi të ndjehemi më në presion dhe më pak të përfshirë në aktivitet. Në natyrë të mësuarit e fëmijëve më të mëdhenj duket se është i motivuar nga jashtë, ata shpesh e shohin atë si mjet për nota të mira, për aprovim nga ana e mësimit apo prindërve në lidhje me afatet apo kërkesat, pra të mësuarit nuk është më shprehje e kuriozitetit dhe interesit të tyre (Deci & Ryan, 1981). Fëmijët e pa motivuar, priren të jenë pasiv dhe të papërgjegjshëm, ata shpesh ndjehen të pafuqishëm dhe mërzhiten shpejt. Të mësuarit e tyre është i ngadalshëm dhe duket kaq i bezdisshëm, ata besojnë se nuk mund të kenë ndonjë ndikim kuptimplotë në ambientin e tyre, andaj priren që të mos veprojnë.

Shumica e klasëve kanë fëmijë që ilustrojnë secilin prej këtyre orinetimeve motivuese. Ka fëmijë që sjelljet e tyre janë burim i motivimit të brendshëm dhe përfshihen në mënyrë direkte në të mësuar, janë kurioz dhe i duan sfidat. Por ka edhe fëmijë të tjerë që duket se bëjnë vetëm atë që u thuhet të bëjnë, varen shumë nga udhëzimet dhe miratimet e mësimit. Së fundmi në shumicën e klasëve, gjejm edhe disa fëmijë që janë pa motiv dhe pasiv, ata nuk kanë performancë të mirë dhe priren të jenë të pafuqishëm (Deci & Ryan, 1981). Në arsim motivimi ka të bëjë me motivimin e nxënësve për të mësuar. Sipas (Ames, 1990) “Kur ne i kushtojmë rëndësi të zhvilluarit të motivimit të nxënësve për të mësuar, atëherë ne shqetësohemi nëse nxënësit do të fillojnë aktivitetet e të mësuarit e do të vazhdojnë të jenë të përfshirë në procesin e të mësuarit si dhe të përkushtuar ndaj tij” (fq.14). Meqenëse edukimi modern është i detyrueshëm, motivimi i nxënësve nuk mund të merret si i mirëqenë nga mësimit, por si përgjegjësi për sigurimin e motivimit të tyre (Seifert & Sutton, 2012). Prandaj mësimit është efektiv i ndihmojnë nxënësit e tyre të zhvillojnë qëllime, besime dhe qëndrime që do të mbështesin dhe kontribuojnë në një përfshirje afatgjatë dhe cilësore në të nxënë. Nëse ne vazhdimisht në mënyrë rigorozë motivimin e shohim vetëm si arritje, atëherë ne lehtësisht mund të humbasim vlerat dhe qëllimet tjera të edukimit.

Në anën tjetër, motivimi është i rëndësishëm sepse kontribuon në arritje, por është gjithashtu i rëndësishëm në vetvete si rezultat (Ray, 1992). Të arrish të bësh klasën një komunitet produktiv të të mësuarit është një nga gjërat më të rëndësishme që një mësimit mund të bëjë, ndoshta edhe më e rëndësishme se praktikatat e përdorura në aspektet më formale të mësimit. Krijimi i një komuniteti të tillë të të nxënësit do të përcaktoj se si klasa do të zhvillohet/evolvojë nga një grup

individësh në një grup koheziv i karakterizuar nga pritshmeri të mëdha, marrdhënie të shëndosha dhe kërkime produktive, por njëkohësisht do të ndikoj edhe në angazhimin dhe arritjet e nxënësve. Kjo nuk është një detyrë e thjeshtë, as nuk ka ndonjë recetë të lehtë që do të sigurojë sukses, por është një proces ku duhet pasur guxim për të krijuar klasa që janë ndryshe nga ato që gjejmë sot në shkolla (Arends, 2011).

1.1. Teoritë e motivimit

Konceptet e teorive të motivimit kanë qenë të krijuara për qindra vite, ku kontributi i teoricienteve të hershëm ka qenë kryesisht i përqendruar në derivatet biologjike të njerëzve në përpjekje për të vlerësuar se si këta faktorë kanë një efekt të qenësishëm në motivim. Rëndësia e këtyre teorive është e bazuar në arsyetimin se u ndihmon teoricientëve të kuptojnë se si njerëzit reagojnë ndaj situatave, duke zbuluar “si” dhe “pse-në” e sjelljeve të brendëshme. Këto teori themelore kanë ndihmuar në krijimin e një niveli bazë të njohurive në studimet e sjelljes për teoricientët dhe praktikuesit në fusha shumë – disiplinore. (Joy, Marthaly, Nhu, & Peter, 2018)

Në kërkimet mbi motivimin në arsim, janë krijuar disa teori kryesore ku teoritë më të cituara të motivimit akademik përfshijnë:

1. Teorinë e pritshmërisë – vlerës (expectancy – value theory)
2. Teorinë e njohjes sociale (social cognitive theory)
3. Teorinë e vetëvendosjes (self – determination theory)
4. Teorinë e interesit (interest theory)
5. Teorinë e qëllimit të arritjes (achievement goal theory)
6. Teorinë e atribuimit (attribution theory).

Këto teori janë krijuar për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar drejtimin, fillimin, intensitetin dhe qëndrueshmërinë e sjelljeve të të mësuarit (Urhahne & Wijina, 2023).

1.1.1. Teoria e pritshmërisë – vlerës

Motivimi si një konstrukt kompleks është i ndikuar nga faktorë të shumtë dhe të ndryshëm, ku në fushën e arsimit këta faktorë mund të përfshijnë: qëllimet, interesin e nxënësit, vetë – efikasitetin dhe vetëvendosjen. Këta përcaktues të ndryshëm bashkohen në dy burime themelore të motivimit:

pritshmëria e suksesit dhe vlera që i atribuohet një qëllimi të caktuar, dhe shpeshherë kjo kornizë referohet si modeli i “pritshmërisë – vlerës” së motivimit, ku në mënyrë matematikore pasqyrohet si: $\text{pritshmëria} * \text{vlera} = \text{motivimi}$. Me fjalë të tjera, për të përjetuar motivimin një individ duhet të ketë një pritje të arsyeshme për sukses dhe vlerësim pozitiv për detyrën në fjalë (Kurt, 2023).




Figura 1. Konstrukti i vlerës dhe i pritshmërisë (Kurt, 2023)

Sipas (Vroom, 1964) ekzistojnë dy nënkomponent kryesor të faktorit të pritshmërisë, ku nënkomponenti i parë lidhet me besimin e individit mbi aftësitë e tij personale për të kryer një aktivitet të caktuar sipas një niveli të kërkuar (pritshmëria), ndërsa nënkomponenti i dytë përfshinë lidhjen në mes të një aktiviteti të kryer dhe rezultatit të dëshiruar. Integrimi i këtyre dy nënkomponenteve bëhet përsëri përmes shumzimit, ashtu që pritshmëria e përgjithëshme është e lartë kur një individ beson se ai personalisht është në gjendje të kryej një aktivitet të dhënë dhe se kryerja e sukseshme e këtij aktiviteti ka të ngjarë të çojë në rezultatit të dëshiruar (Studer & Knecht, 2016). Modeli më tej diferencon vlerën e detyrës në katër komponentë: “vlerën e arritjes (d.m.th. rëndësinë e të bërit mirë), vlerën e brendshme (d.m.th. kënaqësinë personale), vlerën e dobisë (d.m.th. dobinë e perceptuar për qëllimet e ardhshme) dhe koston (d.m.th. konkurrenca me qëllimet tjera)” (Wigfield & Eccles, 2002).

Pritshmëria për sukses ndërlihet më fuqishëm me performancën p.sh. një vajzë e cila beson se do të ketë rezultate të mira në matematikë priret të marrë notë më të lartë sesa një vajzë e cila nuk pret që do të ketë rezultate të mira. Ndërsa vlera e detyrës lidhet më fort me zgjedhjet që ndërlihen me arritjet p.sh. një vajzë që e vlerëson matematikën ka më shumë gjasa të ndjek një kurs të avancuar të matematikës sesa një vajzë që nuk e vlerëson atë, ku në përmbledhje kjo teori thekson rëndësinë e dyfishtë të pritshmërisë për sukses dhe vlerës në shpjegimin e motivimit të fëmijëve (Leaper, 2011).

1.1.2. Teoria e njohjes (kognitive) sociale

Albert Bandura është themeluesi i teorisë kognitive sociale. Kjo teori bazohet në konceptin se të mësuarit ndikohet nga faktorët personal (kognitiv), faktorët e mjedisit dhe të sjelljes. Njerëzit ndikohen dhe ndikojnë në mënyrë aktive në mjediset e tyre, andaj Bandura thekson rolin e të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit, përvojës sociale dhe determinizmin reciprok në sjelljen njerëzore (Nickerson, 2023). Një nga eksperimentet më klasike që ndërlidhen me të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit është eksperimenti “Bobo Doll”, ku nëpërmjet tij demonstrohet se si fëmijët janë në gjendje të mësojnë një sjellje sic është agresioni vetëm nëpërmjet procesit të vëzhgimit të sjelljes së një personi tjetër (McLeod, 2023).

Përvec të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit që paraqet një mekanizëm të fortë që ndikon në ndryshimin e sjelljes, gjithsesi se duhet pasur në konsiderat edhe besimin individual të personit në aftësitë e tij/saj kur shqyrtojmë adoptimin dhe vazhdimin e një sjellje të re, meqenëse koncepti i vetë – efikasitetit paraqet një komponent thelbësor të kësaj teorie (Main, 2023). Një tjetër komponent edhe më thelbësor i kësaj teorie është edhe determinizmi reciprok i cili i referohet “ndërveprimet dinamik dhe reciprok të njerëzve – individëve me një sërë përvojash të mësuara – ambientit, kontekstit të jashtëm shoqëror dhe sjelljes – si përgjigje ndaj stimulave për të arritur qëllimet” (Nickerson, 2023).

Meqenëse kjo teori thekson rëndësinë e faktorëve personal, të tillë si vetë – efikasiteti, pritshmëria e rezultatit, si dhe rolin e mjedisit në formësimin e përvojave të të nxënësit atëherë mësuesit mund të krijojnë mjedise mësimore që ushqejnë te nxënësit vetëbesim, motivim dhe qëndrueshmëri duke zbatuar këto parime nëpërmjet hartimit të aktiviteteve në klasë që nxisin tek ta besimin në aftësitë e tyre, promovojnë kontrollin personal dhe lehtësojnë zhvillimin e aftësive thelbësore (Main, 2023).

1.1.3. Teoria e vetëvendosjes

Teoria e vetëvendosjes erdhi si rezultat i punës së Edward Decit dhe Richard Ryan. “Parimet thelbësore të kësaj teorie theksojnë një marrëdhënie ndërmjet “tri nevojave themelore” (autonomisë, lidhjeve, kompetencës) dhe ndërmjet motivimit të brendshëm e atij të jashtëm”

(Vanner, n.d.).Për herë të parë këto ide ata i shfaqën në librin e tyre të vitit 1985: “Vetëvendosja dhe motivimi i brendshëm në sjelljen njerëzore”, ku sygjerojn që njerëzit priren të udhëhiqen nga nevoja e tyre për t’u rritur dhe për t’u përmbushur, pra njerëzit bëhen të vetëvendosur atëherë kur nevojat e tyre për kompetencë, lidhje, dhe autonomi përmbushen (Kendra, 2022).

Kjo teori është përdorur shpeshëherë edhe nga mësimdhënësit për të kuptuar motivimin e nxënësve në shkollë në përgjithësi si dhe motivimin e tyre për lëndë të ndryshme shkollore (Guay, 2021).Ekzistojnë disa strategji se si mësimdhënësit mund ta integrojnë këtë teori në procesin e mësimdhënies:

- **Mbështetja e autonomisë:** performanca rritet kur njerëzit besojnë se janë të përfshirë në sjellje të vetëqeverisura, ku një nga metodat e mbështetjes së autonomisë së nxënësve do të ishte dhënia e mënyrave të shumta për të përfunduar një detyrë apo për të zgjedhur një problem, lejimi që ata vet të zgjedhin metodën e tyre të perferuar për ta bërë këtë (Amanda, 2021).
- **Inkurajimi i lidhjes/marrëdhënies:** marrëdhënia përkon me ndjenjën e të qenurit i lidhur me të tjerët apo me ndjesinë e përkatësisë.Për të inkurajuar ndjenjën e përkatësisë një mësimdhënës mund të marrë si synim mësimin e emrave të nxënësve të tij, të inkurajoj të mësuarit aktiv dhe bashkëpunues, të pyes nxënësit se si mund të ndërliqen personalisht me temën që po mësojnë, të kërkoj “feedback” nga nxënësit dhe t’ua bëjë me dije se e vlerëson “feedback-un” e tyre, e poashtu bashkëpunimi me kolegë, shkëmbimi i ideve dhe mënyrave ndryshme të inkurajimit e motivimit të nxënësve (Amanda, 2021).
- **Kultivimi i kompetencës:** kompetenca i referohet ndjenjës efektive në kontekstin e mjedisit social të dikujt.Ata që ndjehen më kompetentë, kanë më shumë dëshirë të sfidohen.Mësimdhënësit për të rritur kompetencën tek nxënësit mund të përdorin burime të ndryshme vizuale, strategji të ndryshme të leximit dhe të marrjes së shënimeve, thjeshtësimin e materialeve, si dhe krijimin e aftësive për vendosjen e qëllimeve (Amanda, 2021).

1.1.4. Teoria e interesit

Gjersa një kuptim i saktë i motivimit njerëzor vazhdon të zhvillohet tutje, shumë prej koncepteve tashmë vetëm se kanë dhënë një kontribut të pa mohueshëm në të kuptuarit tonë për motivimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të modeleve dhe teorive motivuese (Harackiewicz & Maximilian, 2017). Zhvillimi i pothuajse të gjitha aftësive, njohurive, zakoneve dhe qëndrimeve në edukim bëhet përmes procesit mësimor. Arritja e rezultateve të mira të të nxënësve përfshin disa komponentë, si interesat, talentet, faktorët psikologjikë, aftësitë, motivimin, qëndrimet, pjekuria, disiplina dhe komponentë të tjerë (Herpratiwi & Tohir, 2022). Si njëri ndër komponentët thelbësorë të suksesit akademik, interesi është një proces mjaftë i fuqishëm që i jep energji të nxënësve dhe që drejton trajktoret akademike dhe atë të karrierës. Prandaj mund të thuhet që interesi është një gjendje psikologjike ku nxënësi shfaq përpjekje dhe vëmendje të shtuar për të përjetuar një moment të caktuar (interesi i situatës) si dhe një lloj predispozite ku nxënësi mund të shfaq interes të mëtutjeshëm për tu angazhuar në një temë të caktuar me kalimin e kohës (interesi individual) (Harackiewicz, Smith, & Priniski, 2016).

Në ShBA, Dewey shquhet si një pararendës i kërkimit modern të interesit. Sipas tij në librin “Interest and Effort in Education” (1913), ekziston një dallim thelbësor ndërmjet të mësuarit e orientuar nga interesi dhe të mësuarit e detyrueshëm (të mësuarit që neglizhon interesat e një nxënësi). Përpjekjet e jashtme për të bërë dicka interesante janë thjeshtë përpjekje të përkohshme sepse të mësuarit e bazuar në përpjekje është mekanik dhe rezulton me njohuri dhe zakone të trajnuara, por që nuk kanë asnjë qëllim apo vlerë intelektuale. Për këtë arsye ai vuri në pah tre karakteristikat themelore të interesit: a) është një gjendje aktive, b) bazohet në objekte reale, dhe c) ka kuptim të fortë personal (Schiefele, 1991).

Ashtu si e vecuam edhe më lartë kur ne flasim për interesin atëherë flasim për interesin e situatës i cili më pas mund të kalojë në interes personal, p.sh. nëse një nxënësi rastësisht sheh një pikturë të Monetit në orën e historisë së artit, ai/ajo mund të mahnet në atë moment nga ngjyrat e ndezura, nga mënyra se si është përdorur brusha për ta realizuar pikturën etj. dhe si rezultat mund t’i kushtoj më shumë vëmendje dhe të angazhohet më thellë (Harackiewicz, Smith, & Priniski, 2016). Meqenëse interesi paraqet një element thelbësor për suksesin akademik, ndërhyrjet apo intervenimi nga ana e mësimit për të zhvilluar interesin e nxënësve ka shumë rëndësi dhe është më se i nevojshëm sidomos në ato fusha akademike ku nxënësit fillimisht nuk i shohin si interesante, por edhe në lëndët apo fushat në të cilat me kalimin e kohës bie interesi ndaj tyre (Harackiewicz, Smith, & Priniski, 2016).




Figura 2. Modeli konceptual që tregon se si ndërhyrjet nxisin zhvillimin e interesit dhe rezultatet e mëvonshme arsimore

Adapted from: (Harackiewicz, Smith, & Priniski, 2016) .

1.1.5. Teoria e qëllimit të arritjes

Thelb i studimit të kësaj teorie është mënyra se si nxënësit e kuptojnë suksesin, dhe synimet që ata vendosin t'i arrijnë (Butler, 2023). Në rastin e teorisë së qëllimit të arritjes kompetenca shihet si aftësi për të bërë dicka në mënyrë efektive, të mjaftueshme dhe të suksesshme, andaj pavarësisht modelve gjithnjë në zhvillim studuesit pajtohen që konstrukti i kompetencës është qendër e kësaj teorie (Chazan, Pelletier, & Daniels, 2021). Kjo teori dhe teoricientët e saj na argumentojnë që shkalla e motivimit të një individi për të arritur një qëllim të caktuar është gjithmonë e ndikuar nga orientimi i qëllimit. Janë dy mënyra se si ne mund t'i qasemi një qëllimi:

- Qëllimi për të zotëruar: pra vendosja e një qëllimi me synim për të zotëruar një aftësi apo detyrë, si dhe

- Qëllimi i performancës: apo vendosja e një qëllimi për të arritur një rezultat të jashtëm si p.sh. një trofe (Paul & Drew, 2023)

Por, në përgjithësi studuesit theksojnë se “qëllimet për të zotëruar” karakterizohen nga elasticiteti, motivi i brendshëm dhe vendosmëria më e madhe për të arritur qëllimin, në krahasim me “qëllimet e performancës”, të cilat zakonisht priren të cojnë në zbehje të motivimit me kohën për shkak të varëshmërisë nga shpërblimet e jashtme (Paul & Drew, 2023). Për të adresuar valencën studiuësit filluan me dallimin e “qasjes” dhe “shmangies” në arritjen e qëllimit, që nënkupton të punosh për të arritur suksesin apo por t’iu shmangur dështimit. Pra motivimi i qasjes ka të bëjë me sjelljen e drejtuar drejt një rezultati të dëshiruar apo pozitiv, ndërsa motivimi i shmangies është një sjellje e drejtuar për t’i ikur një rezultati negativ (Chazan, Pelletier, & Daniels, 2021).

Tabela 1: Matrica e teorisë së qëllimit të arritjes

	Qasja	Shmangia
Zotërimi	Shembull: qëllimi im është të mësoj sa më shumë të jetë e mundur.	Shembull: qëllimi im është të mos mësoj më pak se sa është e mundur.
	Aplikimi: një nxënës që dëshiron të mësojë sa më shumë të jetë e mundur rreth trigonometrisë për të përmirësuar veten e tyre.	Aplikimi: një nxënës që zgjedh probleme më të lehta të llogaritjes për të shmangur keqkuptimin e parimeve në një problem më sfidues.
Performanca	Shembull: qëllimi im është t’ua kaloj të tjerëve.	Shembull: qëllimi im është të mos jem më keq se të tjerët.
	Aplikimi: një nxënës që synon të përfundoj më shpejt dhe saktë fletën e punës sesa shokët/shoqet e klasës si dëshmi e aftësisë së tyre.	Aplikimi: një nxënës shmang ngritjen e dorës në një diskutim në klasë nëse nuk është i sigurt në përgjigjen e tij/saj, për të parandaluar që të duket i paaftë në krahasim me bashkëmoshatarët e tij/saj.

Shënim: Mostrat janë marrë nga pyetsori “Achievement Goal Questionnaire (AGQ)” (Elliot & Murayama, 2008).

1.1.6. Teoria e atribuimit

Teoria e atribuimit për herë të parë u prezentua nga Weiner dhe është modeli i vetëm motivues që në thelb përfshinë të dyja, si anën kognitive po dhe atë emocionale të individit të cilat ndikojnë në sjelljen njerëzore. Kjo teori thekson që njerëzit gjithmonë janë në kërkim të të kuptuarit e arsyeve të suksesit apo dështimit të tyre, andaj fokus i saj është analiza e shkaqeve të suksesit apo dështimit, se si identifikohen apo interpretohen këto shkaqe të cilat më pas kanë edhe një ndikim në qëndrimet dhe veprimet e ardhshme të individit, kur ata ballafaqohen me situatë të ngjajshme (Kalman & Eugenio, n.d.).

Atributet përbëhen nga tre dimensione të shkakut:

- **Vendndodhja** i referohet burimit të shkaqeve në lidhje me vetvetën (brendshme vs. jashtme).
 - Shkaqet e brendshme burojnë brenda vetës (p.sh. do të duhej të mundohesha më shumë)
 - Shkaqet e jashtme burojnë nga jashtë (p.sh. detyra ishte e vështirë) (Winchester, Barrero-Molina, & Long, 2021).
- **Stabiliteti** i referohet asaj se sa të qëndrueshme janë shkaqet me kalimin e kohës (të paqëndrueshme vs. të qëndrueshme)
 - Shkaqet e paqëndrueshme shihen si dicka që mund të ndryshohen (p.sh. do të përpiqem më shumë herën tjetër)
 - Shkaqet e qëndrueshme shihen si të pandryshueshme (p.sh. thjesht nuk jam i suksesshëm në shkollë) (Winchester, Barrero-Molina, & Long, 2021).
- **Kontrollueshmëria** i referohet nivelit të kontrollit mbi situatën që njeriu e percepton vetën se ka (i kontrollueshëm vs. i pakontrollueshëm)
 - Shkaqet e kontrollueshme shihen si dicka mbi të cilën kemi kontroll (p.sh. herën tjetër do të kërkoj ndihmë)
 - Shkaqet e pakontrollueshme shihen si dicka mbi të cilën nuk kemi kontroll (p.sh. kam fat të keq me testet) (Winchester, Barrero-Molina, & Long, 2021).

Tabela 2: Shembull – Një nxënës dështon në test dhe më pas reflekton mbi shkaqet e dështimit.

Vendndodhja	
E brendshme: “Unë mora një notë të dobët sepse nuk e kam kuptuar temën, nuk kërkova ndihmë dhe nuk mësova mjaftueshëm”.	E jashtme: “Unë mora një notë të dobët sepse mësimdhënësi nuk e ka shpjeguar mirë materialin”.
Stabiliteti	
E paqëndrueshme: “Unë dështova sepse nuk e kuptova materialin, herën tjetër do të kërkoj ndihmë nga mësimdhënësi në mënyrë që të jem më i përgatitur”.	E qëndrueshme: “Kam dështuar në provim sepse nuk jam mirë me mësimet dhe nuk jam mjaftueshëm i zgjuar, kjo nuk do të ndryshojë kurrë”.
Kontrollueshmëria	
E kontrollueshme: “Dështova sepse e kalova pasditen duke luajtur videolojëra në vend që të rishikoj shënimet e mija. Unë do të marrë notë më të mirë nëse përpiqem më shumë dhe kaloj më shumë kohë duke mësuar”.	E pakontrollueshme: “Dështova sepse testi ishte formuluar keq dhe fqinjët e mi janë gjithmonë të zhurmshëm kur unë përpiqem të mësoj”.

Adapted from (Winchester, Barrero-Molina, & Long, 2021)

1.2. Krijimi i mjedisit për të nxënë dhe klima motivuese në klasë

Për fëmijët pavarësisht nga besimi dhe zakonet e tyre kulturore, e rëndësishme për ta është krijimi i një klase ku ata kënaqen duke mësuar dhe ku jepet mundësia për të luajtur, për tu ndjerë të lumtur e të sigurt. Krijimi i një klime pozitive si dhe mjedisi i klasës luajnë një rol thelbësor në marrëdhëniet mësimdhënës – nxënës, gjë që ndikon edhe në motivimin e nxënësve e që reflektohet poashtu në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënit. Light dhe Spada (1999), e vënë theksin mbi rëndësinë e motivimit duke theksuar: “Mënyra kryesore se si mësimdhënësit mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve është duke e bërë klasën mjedis mbështetës në të cilin nxënësit stimulohen dhe angazhohen në aktivitete” (Al-Shawi, 2014, fq. 163).

Që të arrij mësimdhënësi/sja të krijojë një klimë pozitive dhe një mjedis të ngrohtë, harmonik ku nxënësit ndihen komod në të mësuarit e tyre, atëherë ai/ajo duhet të ketë parasyshë disa strategji:

- 1. Bashkëveprimi** – është kyc në krijimin e një klime pozitive. Planifikimi i veprimtarive, parashtrimi i kërkesave ndaj nxënësve për mësim dhe sjellje të përshtatshme, dhënia e sinjaleve të qarta, kalimi nga një veprimtari në tjetrën me qetësi si dhe parashikimi e

parandalimi i problemeve para se ato të fillojnë, pra përzgjedhja e veprimtarive të tilla në mënyrë që rrjedha e interesi i nxënësit të ruhen e të rriten e jo të shuhen (Hoxhaj, 2015).

- 2. Rregullat** – ngulitja e drejtpërdrejtë e rregullave dhe procedurave në klasë sidomos te nxënësit e kopshtteve apo të viteve të para shkollore, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Rregullat që zbatohen në mënyrë konsekuente mund të kenë efekt pozitiv në motivimin e nxënësve për të nxënë sepse nxitin përvijimin e mjedisit të sigurt dhe të ngrohtë në klasë (Hoxhaj, 2015).

Krijimi i klimës pozitive të klasës :

- Nxënësi shihet si individ me veti të mira, por edhe me nevoja.
- Nxiten për sukses.
- Mësimi nëpërmjet bashkëpunimit.
- Fëmijët i japin kontribut shkollës dhe mburren me të (Hoxhaj, 2015).

Mbretëron atmosferë kujdesi në klasë:

- Cdo fëmijë shihet si i vecantë e unik.
- Nga fëmijët nuk kërkojmë vetëm përfitimin e njohurive, por edhe veti të tjera.
- Sjelljet pozitive shpërblehen.
- Situatat konfliktuoze zgjidhen në mënyrë që fëmija kupton mënyrat e drejta të zgjedhjes (Hoxhaj, 2015).

Klasët janë njësi fizike dhe organizative ku ekziston një lidhje në mes strukturës fizike dhe mënyrës së rregullimit të klasës, shpërndarjes së hapësirës, vendosjes së nxënësve e mësimdhënësit, ku karakteristikat e saj fizike të mjedisit mund të ndikojnë si në sjellje ashtu edhe në programin mësimor, dhe ky fakt nuk mund të injorohet (Martin, 2002).

1.3. Roli i mësimdhënësit në motivimin e nxënësve

Ekzistojnë një numër i sërë faktorëve të jashtëm e të brendshëm të cilët kanë ndikim në motivimin e nxënësve për të mësuar, ndonëse nxënësi mund të ketë një dëshirë të lindur për të mësuar, mbështetja e jashtme e ofruar nga mësimdhënësi ka një ndikim të rëndësishëm në të nxënë. Roli i një mësimdhënësi nuk është thjeshtë i kufizuar vetëm në krijimin e një ambienti komod, por përfshinë edhe aftësin e tij për të zhvilluar kompetencën dhe autonominë e nxënësve, e poashtu nxitjen e interesit të tyre për të mësuar si faktorë të rëndësishëm në motivimin e nxënësve në të

nxënë (Singh & Parsad, 2021). Sipas Dorney mësimit mund të rrisin motivimin e nxënësve nëpërmjet aktiviteteve të reja, sfiduese dhe jo monotone. Ai poashtu thekson 3 tipare të rëndësishme të personalitetit që janë karakteristika bazë të mësimit:

- Empatia (ndjeshmëria) – i referohet të qenit i ndjeshëm ndaj nevojave, ndjenjave dhe perspektivave të nxënësit (Demir, 2021).
- Balancimi (harmonia) – i referohet një mësimit që mund të jetë i vërtetë me vetën dhe autentik (Demir, 2021).
- Pranimi – si karakteristika e fundit, që nënkupton se një mësues duhet të mos gjykojë dhe të ketë vlerësim pozitiv duke pranuar çdo nxënësi (Demir, 2021).

D.Cock and H.Halvari (sic janë cituar në Efkliides. A, 2001), thonë se: “mësimit në vecanti është figurë e rëndësishme për shumicën e nxënësve dhe se ka një pozicion unik në mjedisin e klasës” (Demir, 2021). Ashtu si një makinë që nuk do të funksionojë pa karburant, ashtu edhe nxënësit nuk do të mësojnë pa motivim, andaj është detyrë e një mësimit që të zhvillojë mjetet dhe metodat për të mundur dhe lehtësuar motivimin e tyre sepse jo çdo nxënësi është i motivuar në mënyrë intuitive dhe të brendshme (Reid, 2007).

2. METODOLOGJIA

Hulumtimi “Rëndësia e motivimit të nxënësve nga ana e mësimit në lëndën gjuhë shqipe në Komunën e Mitrovicës” është hulumtim me qasje cilësore. Qëllimi i këtij hulumtimi është hulumtimi i rolit dhe rëndësisë së mësimit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe si dhe rolit të motivimit të brendshëm e atij të jashtëm, e poashtu edhe rolit të mjedisit mbështetës e inkurajues.

Pyetjet kërkimore:

1. A luajnë rol të rëndësishëm mësimit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?
2. Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm a luajnë një rol kyç në motivimin e nxënësve në gjuhën shqipe?
3. Krijimi i një mjedisi inkurajues dhe mbështetës mund të ndikojë në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?

2.1. Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit e këtij hulumtimi janë 6 mësimit/e të klasës së pestë të dy shkollave fillore “Andon Zako Cajupi” në qendër të qytetit si dhe shkolla fillore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në fshatin Vaganicë të Komunës së Mitrovicës.

2.2. Instrumenti i hulumtimit

Instrumenti i këtij punimi hulumtues është fokus – grupi, pyetjet janë përpiluar nga hulumtuesja. Pyetjet e realizuara gjatë fokus – grupit janë gjysmë të strukturuar dhe kërkojnë përgjigje të hapur nga pjesëmarrësi. Gjithsej janë realizuar 9 pyetje dhe pyetje shtesë varësisht nga mundësitë e ofruara gjatë diskutimit dhe rrjedhës së saj. Pyetjet janë pilotuar.

2.3. Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Fokus – grupi me gjashtë mësimit/et është realizuar në sallën e arsimtarëve tek të dy shkollat “Andon Zako Cajupi” si dhe “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, gjatë pauzave të mësimit (gjatë asaj kohe kur nxënësit kanë mbajtur orën e gjuhës angleze). Kohëzgjatja e

realizimit të intervistes me mësimdhënësit/et ishte pothuajse 30 min. Pyetjet e realizuara në diskutim u shtruan nga unë dhe përgjigjet e tyre janë shkruar në bllok për t'i analizuar më pas.

2.4. Aspekti etik

Etika hulumtuese është respektuar. Të dhënat e mbledhura janë shfrytëzuar vetëm për qëllim studimi dhe pjesëmarrja e participantëve ishte e vullnetshme. Të dhënat personale të pjesëmarrësve janë konfidenciale.

2.5. Kufizimet e hulumtimit

Numri i vogël i pjesëmarrësve në hulumtim është një kufizim i studimit dhe rezultatet e nxjerra nuk mund ta përgjithësojnë popullatën.

3. REZULATET

Gjetjet nga mësimdhënësit/et. Mësimdhënësit theksuan se motivimi nga ana e tyre, po edhe motivimi i brendshëm e ai i jashtëm së bashku me ambientin luajn një rol kyc dhe të rëndësishëm në vet motivimin e nxënësve, jo vetëm në lëndën e gjuhës shqipe, por edhe në lëndë tjera.

Të pyetur “Sa është i rëndësishëm motivimi i nxënësve për juve dhe pse?”, nga ana e mësimdhënësve u dhanë këto përgjigje: “Motivimi për mua është një ndër pjesët më të rëndësishme të mësimdhënies sepse përmes tij angazhimi, vetëbesimi dhe rezultatet e nxënësve janë në nivel, andaj edhe gjatë punës përdor metoda të ndryshme për motivimin e tyre sepse tek ta krijohet një frymë edhe e mësimnxënies por edhe e konkurrencës” (Respodenti 1); “Motivimi është i rëndësishëm jashtë të gjitha normave sepse fal motivimit të vazhdueshëm mund të arrihen edhe rezultatet e dëshiruara” (Respodenti 2); “Motivimi ka një rëndësi të vecantë dhe luan një rol kyc në procesin e mësimnxënies, sepse kur një nxënës është i motivuar është në gjendje të ketë një rol aktiv dhe t’i kuptojë njësit mësimore, kurse kur nuk është i motivuar atëherë edhe performanca e tij/saj është më e dobët” (Respodenti 3); “Pa dyshim që motivimi luan një rol të rëndësishëm dhe është një ndër shtyllat e të nxënësve të suksesshëm” (Respodenti 4); “Për neve mësimdhënësit është shumë e rëndësishme që brenda në klasë të kemi nxënës të motivuar, sepse në këtë mënyrë ata përfshihen dhe angazhohen sipas kërkesave” (Respodenti 5); “Sigurisht që motivimi paraqet një faktorë të rëndësishëm në procesin e mësimnxënies, meqenëse edhe një pjesë e suksesit të nxënësve vije si rezultat i tij” (Respodenti 6).

Në pyetjen tjetër drejtuar mësimdhënësve, “A mendoni që nëse ju krijoni një klimë të mirë në klasë mund të ndikoj në motivimin e fëmijëve gjatë të mësuarit të gjuhës shqipe?”, të gjithë mësimdhënësit u pajtuan që një klimë e mirë në klasë ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve: “Është shumë e rëndësishme që të krijojmë një klimë të mirë në klasë, sepse krijimi i saj është dyfishi i të nxënësve. Për mua ka rëndësi që nxënësit e mi të vijnë me plotë dëshirë në klasë, sepse e dijnë që edhe nëse nuk kanë kuptuar dicka nga njësia mësimore në shtëpi, në klasë kanë një mësimdhënëse dhe shok/shoqe që e mbështesin” (Respodenti 1); “Po, gjithësesi. Ajo që unë mundohem gjithmonë të bëjë është krijimi i një mjedisi ku ofrohen kushtet e përshtatshme të mësimnxënies, ku mbizotëron bashkëpunimi dhe respekti ndaj njëri – tjetrit një klimë ku nxënësit ndihen të përfshirë, të angazhuar dhe të vlerësuar kur ata jepen një mendim apo ide” (Respodenti 3); “Patjetër, mendoj që secila mësimdhënëse mundohet të përdorë metodologji të ndryshme për të krijuar një klimë të përshtatshme brenda klasës në mënyrë që nxënësit të mësojnë me lehtësi dhe dëshirë në lëndën e gjuhës shqipe” (Respodenti 6)

Të pyetur: “Si e bëni ndërlidhjen në mes të vetëbesimit të nxënësit dhe motivimit?” u dhanë këto përgjigje: “Unë mendoj që ndërlidhja e tyre qëndron në vet faktin se një nxënës i motivuar ka një vetëbesim më të thellë dhe është i gatshëm të jetë aktiv e të shpreh mendimin e tij/saj gjatë orës mësimore. Shpeshherë për të parë vetëbesimin e tyre u bëjë edhe ndonjë pyetje më sfiduese, me qëllim që t’i inkurajoj ata të thonë përgjigjen që kanë ndërmend” (Respodenti 1); “Ndërmjet tyre ekziston një ndërlidhje e ngushtë, sepse kur një nxënës ka vetëbesim atëherë i duhet vetëm pak

motivim që ai/ajo të eci para, ndërsa kur një fëmijë nuk ka aq shumë vetëbesim atëherë patjetër që duhet të ndërlihet një dozë shumë më e madhe e motivimit që ai/ajo të shtyhet para” (Respodenti 2); “Nga përvoja personale, mendoj që ekziston një lidhje e fort midis tyre meqenëse në shumë raste kur kam parë që ndonjë nxënës është mjaftë i dijshtëm por është më i tërhequr që të shprehet, atëherë gjithmonë jam munduar ta motivoj me metoda të ndryshme dhe kam arritur që pas një kohe të shoh rezultat, ata nxënës kanë qenë më aktiv dhe me më shumë besim tek vetja” (Respodenti 3); “Këtë lidhje në mes tyre e shoh në shumë raste kur kam arrit me ngrit vetëbesimin e nxënësve me anë të motivimit, qoftë me notë, lëvdatë apo figura” (Respodenti 4); “Unë shembull nga përvoja personale kam një nxënës me vështërsi në të folur, dhe kam arrit që nëpërmjet motivimit por edhe mbështetjes së shokëve/shoqeve ta ndihmoj në ngritjen e vetëbesimit të tij” (Respodenti 5); “Padyshim që motivimi dhe vetëbesimi kanë një ndërlihetje të fort ndërmjet vete, sepse me motivim arrihet edhe ngritja e vetëbesimit” (Respodenti 6).

Të pyetur: “A mendoni se metodologjitë e caktuara të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve?”, përgjigjet e tyre ishin këto: “Po patjetër, përdorimi i metodologjive të ndryshme ka një ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve, një ndër to është edhe mësimdhënia e bazuar në projekte, pastaj sidomos tani që shkolla jonë ka fituar edhe donacione të pajisjeve teknologjike është një bonus i madh sepse i shfrytzojmë gjatë orës për ta bërë atë sa më atraktive” (Respodenti 1); “Mendoj se po deri diku, por besoj dhe mendoj në bazë të përvojës time të punës që ekzistojnë edhe faktorë tjerë që luajnë një rol kyc” (Respodenti 2);

“Po, patjetër. Ekzistojnë një mori e metodologjive të të nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe që ne përdorim e që kanë një ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve, shembull puna në grupe është një formë që sjell rezultate pozitive” (Respodenti 4).

Në pyetjen tjetër drejtuar mësimdhënësve: “Si e kuptoni që një fëmijë nuk është i motivuar?”, pothuajse të gjithë dhanë të njëjtat tipare: “Po është shumë e lehtë në momentin që ai/ajo nuk ndëgjon, nuk të përcjell me sy, nuk është i koncentruar, kur i bënë një pyetje nuk përgjigjet, këto janë disa prej tipareve” (Respodenti 5); “E kuptoj në bazë të sjelljeve, në bazë të gjesteve, në bazë të përgjigjeve që ai/ajo jep, do të thotë ka disa indikator që të bjënë të kuptosh që ai/ajo nuk ka motivim” (Respodenti 6).

Të pyetur: “Si veproni në rastet kur një fëmijë nuk është i motivuar?” përgjigjet e mësimdhënësve ishin këto: “Zakonisht e afrojmë më afër vetës, e lehtësojmë pak më shumë me fjalë përkëdhelëse “bravo, të lumtë, ti mundesh edhe më shumë, le ta provojmë përsëri, unë jam e bindur që herën tjetër do ta marrësh 5 e fjalë të tjera motivuese” (Respodenti 1); “Kur një nxënës nuk është i motivuar zakonisht mundohem t’i stimuloj në ngritjen e vetëbesimit të tij/saj, duke u dhënë informata kthyesë që është në favor të tij/saj, që e rregullon gjendjen emocionale të tyre, i motivoj me ndonjë notë, me ndonjë fjalë magjike (të lumtë, vetëm vazhdo kështu, je i/e mrekullueshëm etj.), pra me metoda të ndryshme” (Respodenti 2); “Unë gjithmonë mundohem të gjej thelbin apo arsyen pse nxënësi nuk është i motivuar, prandaj zakonisht kam dëshirë të ndaj disa minuta për ta pyetur në lidhje me mos interesimin e tij/saj, në mënyrë që pastaj të kuptoj se si të veproj tutje”, theksoi (Respodenti 3)

Të pyetur: “A luan rol të rëndësishëm mësimdhënësi në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?” padyshim që të gjithë mësimdhënësit theksuan rolin e tij si figurë: “Po, patjetër mendoj që mësimdhënësi në grumbullin e shumë indikatorëve të tjerë që ndikojn në motivimin e nxënësve, një pjesë të konsiderueshme e ka edhe vet ai/ajo” (Respodenti 1); mësimdhënësjat tjetër u përgjigj kështu: “Gjithsesi, mësimdhënësit janë pika kyce e motivimit të nxënësve, por njëkohësisht mendoj që janë edhe pika kyce e demotivimit të tyre” (Respodenti 2); “Jashtëzakonisht luan një rol të madh, sepse kur arrin që nxënësit t’i bëjë të ndjehen të vlerësuar për angazhimin dhe përpjekjet e tyre, normalisht që edhe interesimi i tyre për lëndën rritet” (Respodenti 4).

Në pyetjen e radhës: “Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm a luajn rol kyç në motivimin e nxënësve në gjuhën shqipe?” përgjigjet ishin këto, pothuajse të ngjashme: “Po, motivimi i brendshëm dhe i jashtëm që të dy luajn rol kyç, jo vetëm në lëndën e gjuhës por në secilen lëndë tjetër” (Respodenti 6); “Gjithsesi, rezultate pozitive kemi në të dy rastet edhe kur nxënësi është i motivuar nga brenda, por edhe kur ne e motivojmë nga jashtë” (Respodenti 5); “Mendoj që motivimi i brendshëm ka të bëjë me një interes më afatgjatë dhe personal të nxënësit, kurse ai i jashtëm ndërlidhet më shumë me shpërblimet, por që të dy padyshim pajtohem që luajn një rol të rëndësishëm” (Respodenti 4).

Të pyetur: “Krijimi i një mjedisi inkurajues dhe mbështetës a mund të ndikoj në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?” të gjithë u pajtuan se mjedisi inkurajues e mbështetës ndikon në motivimin e nxënësve: “Sigurisht që po, ndikon shumë, sepse kur nxënësi ndjehet komod, atëherë edhe motivimi i tij/saj do të jetë më i lartë” (Respodenti 1); mësimdhënësjat tjetër theksoi: “Padyshim, unë këtë e vërej edhe në raste të thjeshta shembull si puna në grupe, kur nxënësit e shohin që angazhohen, përkrahen nga shoku/shoqja, i respektohet mendimi, i besohet një detyrë e caktuar, atëherë motivimi për mësim rritet” (Respodenti 2); “Po ndikon shumë, jo vetëm në motivim por edhe në vetëbesimin e tyre” (Respodenti 3); “Ndikimi i mjedisit është i pashmangshëm, duke filluar nga aspekti fizik i tij e deri te mënyra organizative, normalisht që ka ndikim në motivimin e nxënësve” (Respodenti 4); “Po ndikon, unë personalisht mundohem që të ofroj një mjedis inkurajues për nxënësit e mi, duke ua bërë me dije që kanë gjithmonë mbështetjen time” (Respodenti 5); “Po patjetër, sepse nëse nuk krijojmë një mjedis mbështetës atëherë ne nuk mund t’i realizojmë kërkesat dhe pritshmëritë tona” (Respodenti 6).

4. DISKUTIME

Gjetjet theksuan rolin dhe rëndësinë e mësimdhënësit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe. Shumica e mësimdhënësve rolin e tyre, si dhe rolin e motivimit të brendshëm e atij të jashtëm, e poashtu atë të klimës e mjedisit inkurajues në klasë i shihnin si disa nga indikatorët dhe faktorët kyç të motivimit të nxënësve në procesin e mësimnxënies, por pa anashkaluar edhe ndikimin dhe rolin e faktorëve të tjerë. Marrë parasysh edhe studime të tjera që theksojnë rëndësinë e këtyre faktorëve, mund të themi që rezultatet e dala nga ky studim janë të ngjajshme.

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara, arrijmë t'u japim përgjigje pyetjeve hulumtuese. Pyetja e parë hulumtuese ishte: “A luajnë rol të rëndësishëm mësimdhënësit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?”. Gjetjet treguan që mësimdhënësit mendojnë se roli i tyre në motivimin e nxënësve është një ndër faktorët kryesor, mirëpo duke mos zbehur edhe ndikimin e faktorëve të tjerë. Ata përdorin mënyra dhe metodologji të ndryshme për të arritur tek rezultati i dëshiruar.

Të dhënat e mbledhura i dhanë përgjigje edhe pyetjes së dytë të hulumtimit: “Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm a luajn një rol kyç në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?”. Mësimdhënësit e theksonin rëndësin e motivimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, ku e rëndësishme për ta ishte që interesi apo motivimi i brendshëm i nxënësit për një lëndë të caktuar të mos anashkalohet mirëpo t'i jepet përkrahje edhe më shumë duke e përforcuar atë edhe me anë të motivimit të jashtëm, i cili pastaj luan edhe rolin tjetër të ngritjes së vetëbesimit të nxënësve për përfshirje në aktivitete. Ashtu sic edhe e theksojnë (Deci & Ryan, 2000), motivimi i brendshëm i referohet aktivitetit që ndodh si pasojë e kënaqësis që individi ndjen, kurse ai i jashtëm më shumë ndërlidhet me rezultatin, pra me marrjen e ndonjë shpërblimi apo shmangien e ndonjë ndëshkimi (Demir, 2021).

Gjithashtu, rezultatet i dhanë përgjigje edhe pyetjes së tretë të hulumtimit: “Krijimi i një mjedisi inkurajues dhe mbështetës mund të ndikoj në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?”. Gjetjet treguan që mësimdhënësit mendojnë se mjedisi inkurajues dhe mbështetës luan një rol të pazëvendësueshëm në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe. Sipas Qendrës Kombëtare për Mjediset e Sigurta dhe Mbështetëse të të Mësuarit (National Center on Safe Supportive Learning Environments), një mjedis shkollor pozitiv është i lidhur në mënyrë kritike me suksesin e shkollës pasi që mund të përmirësojë pjesëmarrjen e nxënësve si dhe arritjet e tyre akademike (Hudson, 2022).

5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Në bazë të përgjigjeve që kemi marrë nga mësime dhënësit, rezultojnë se roli i mësime dhënësit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe është tejet i rëndësishëm dhe qendror. Mënyrat se si ata arrijnë rezultatet e dëshiruara, pra si arrijnë të motivonin nxënësit, të krijojnë frymë inkurajuese dhe mbështetëse në klasë ishte e ndryshme dhe varej nga rasti në rast.

Duke u bazuar në përgjigjet e dhëna nga mësime dhënësit dhe nga literatura e shqyrtuar për realizimin e këtij hulumtimi, arrijmë në këto përfundime:

- Mësime dhënësi është një figurë kyçe e motivimit të nxënësve në procesin e të mësuarit.
- Krijimi i ambientit inkurajues dhe mbështetës ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve.
- Motivimi i jashtëm ndikon në ngritjen e vetëbesimit tek nxënësi.
- Motivimi i brendshëm luan një faktor të rëndësishëm në mësime nxënie.
- Përdorimi i metodologjive të ndryshme rrit motivimin e nxënësve në të mësuar.

Duke u bazuar në natyrën e këtij hulumtimi, rekomandimet të tjera në këtë fushë janë:

- Sygjerohet të bëhen edhe hulumtime të tjera me një numër më të madh të participantëve, meqenëse mostra ime ishte e vogël.
- Përveç fokus – grupit, të përdoren edhe instrumente tjera.

REFERENCAT:

- Al-Shawi, M. A. (2014). Using Game Strategy for Motivating Students to Learn New English Vocabulary. *American Arabic Academy for Sciences and Technology*, 137-146.
- Amanda, M. V. (2021). *Self-Determination Theory, Motivation and Your Classroom*. Utah: Brigham Young University.
- Ames, C. A. (1990). *Motivation: What Teachers Need to Know*. Teachers College Record .
- Butler, R. (2023). Advances in Child Development and Behavior. *Science Direct*, 1-254.
- Chazan, D. J., Pelletier, G. N., & Daniels, L. M. (2021). Achievement Goal Theory Review: An Application to School Psychology. *Journals*, 1-6.
- Cherry, K. (2023). Motivation: The driving force behind our actions. *very well mind*, 1 - 2.
- Cherry, K. (2022, November 8). *What is Self-Determination Theory?* Retrieved from Very Well Mind: <https://www.verywellmind.com/what-is-self-determination-theory-2795387>
- Deci, E. L., & Ryan, R. M. (1981). *Curiosity and Self-Direct Learning: The Role of Motivation in Education*. Washington, D. C.: National Institute of Education, Washington, D. C.
- Guay, F. (2021). Applying Self-Determination Theory to Education. *Sage Journals*, 1-4.
- Harackiewicz, J. M., & Maximilian, K. (2017). Interest: Theory and Application. In J. M. Harackiewicz, & K. Maximilian, *Interest: Theory and Application*. The Guilford Press, 334-352.
- Harackiewicz, J. M., Smith, J. L., & Priniski, S. J. (2016). Interest Matters: The Importance of Promoting Interest in Education. *National Library of Medicine*, 221-227.
- Herpratiwi, & Tohir, A. (2022). Learning Interest and Discipline on Learning Motivation . *International Journal of Education in Mathematics, Science, and Technology*, 424-435.
- Hoxhaj, E. (2015). Rëndësia e motivimit nga mësuësit në klasat fillore. *Academia*, 28-31.
- I.Arends, R. (2011). *Learning to Teach*. McGraw Hill Education.
- Joy, J., Marthaly, I., Nhu, N., & Peter, M. (2018). *Part 1: Foundational Theories of Human Motivation*. Motivation 101: A Guide for Public Servants 1.
- Kalman, C., & Eugenio, E. G. (n.d.). The Role of Attribution Theory and Its Relation to Intrinsic and Extrinsic Motivation. *Studies in Second Language Learning and Teaching*, 583-608.
- Kendra, C. (2022, November 8). *What is Self-Determination Theory*. Retrieved from Wery Well Mind: <https://www.verywellmind.com/what-is-self-determination-theory-2795387>
- Kurt, S. (2023). Expectancy - Value Theory. *Education Library*, 1-2.
- Leaper, C. (2011, July 9). *Expectancy - Value Theory*. Retrieved from Science direct: <https://www.sciencedirect.com/topics/psychology/expectancy-value-theory>

- Main, P. (2023, May 8). *Social Cognitive Theories*. Retrieved from Structural Learning: <https://www.structural-learning.com/post/social-cognitive-theories>
- Martin, S. H. (2002). The Classroom Environment and Its Effects on the Practice of Teachers. *Environmental Psychology*, 139-156.
- McClelland, D. C. (1955). Studies in Motivation. In D. C. McClelland, *Studies in Motivation* (pp. 424-425). New York: Appleton-Century-Crofts.
- McLeod, S. (2023, June 14). *Bandura's Bobo Doll Experiment On Social Learning*. Retrieved from Simply Psychology: <https://www.simplypsychology.org/bobo-doll.html>
- N.Cofer, C., & L.Petri, H. (2023). Motivation. *Britannica*, 1-3.
- Nickerson, C. (2023, October 10). *Albert Bandura's Social Cognitive Theory: Definition and Examples*. Retrieved from Simply Psychology: <https://www.simplypsychology.org/social-cognitive-theory.html>
- Paul, G., & Drew, C. (2023). Achievement Goal Theory: Definition and Examples. *Helpful Professor*, 1-4.
- Ray, N. L. (1992). *Motivation in Education*. Portales, New Mexico: Eastern New Mexico University.
- Reid, G. (2007). *Motivating Learners in the Classroom: Ideas and Strategies*. New Delhi: Paul Chapman.
- Schiefele, U. (1991). Interest, Learning, and Motivation. *Educational Psychologist*, 299-323.
- Seifert, K., & Sutton, R. (2012, June). *Educational Psychology*. Boston, Massachusetts: Foundations of Learning and Instructional Design Technology.
- Singh, P., & Parsad, M. (2021). The Role of Teachers in Motivating Students to Learn. *New Delhi Publishers*, 30-32.
- Studer, B., & Knecht, S. (2016). *Progress in Brain Research*. Elsevier.
- Tohidi, H., & Jabbari, M. M. (2011). The effects of motivation in education. *Elsevier*, 820-824.
- Urhahne, D., & Wijina, L. (2023). Theories of Motivation in Education: an Integrative Framework. *Springer Link*, 1-3.
- Vanner, A. M. (n.d.). *Self-Determination Theory, Motivation, and Your Classroom*. New York: New York Institute of Technology.
- Vroom, V. H. (1964). *Work and Motivation*. Wiley.
- Wigfield, A., & Eccles, J. S. (2002). Expectancy - Value Theory of Achievement Motivation. In A. Wigfield, & J. S. Eccles, *Expectancy - Value Theory of Achievement Motivation* (pp. 68 - 81). New York: Elsevier.
- Winchester, T., Barrero-Molina, L., & Long, K. (2021). Adaptive Student Attributions. *Oklahoma State University*, 1.
- Wlodkowski, R. J. (1984). Motivation. In R. J. Wlodkowski, *Motivation* (pp. 11-12). Washington, D. C.: National Education Association.

SHTOJCA A**FORMULAR PAJTIMI****UNIVERSITETI I MITROVICËS****“ISA BOLETINI”***Rr.Parku Industrial, p.n. 40000 Mitrovicë**Republika e Kosovës***FAKULTETI I EDUKIMIT****FORMULAR PAJTIMI****I/E nderuar,**

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të Diplomës. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj këtë hulumtim. Hulumtimi do të përcaktoj “Rëndësin e motivimit të nxënësve nga ana e mësimdhënësit në lëndën “Gjuhë shqipe” në Komunën e Mitrovicës”.

Formulari ju ofrohet për t’u pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për qëllimet e këtij studimi. Ju lutem të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen Tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me Ju, Ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

Një kopje e këtij konfirmimi mbetet tek Ju.

Donika Latifi

.....

.....

(Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në vazhdimësi, ju lutem kontaktoni profesoreshën mentore të punimit, Fatbardha Hoxha, në fatbardha.hoxha@umib.net)

Ju faleminderit!

SHTOJCA B – PYETJET E DISKUTIMIT

Intervista e realizuar me mwsimdhwnwsit:

- I. Pyetjet demografike
- II. Pyetjet e diskutimit

1. Sa është i rëndësishëm motivimi për juve dhe pse?
2. A mendoni që nëse krijoni një klimë të mirë në klasë mund të ndikoj në motivimin e fëmijëve gjatë të mësuarit të gjuhës shqipe?
3. Si e bëni ndërlidhjen në mes të vetëbesimit të nxënësit dhe motivimit?
4. A mendoni që metodologjitë e caktuara të të nxënit në lëndën e gjuhës shqipe mund të ndikojnë në motivimin e nxënësve?
5. Si e kuptoni që një fëmijë nuk është i motivuar?
6. Si veproni në rastet kur një fëmijë nuk është i motivuar?
7. A luajnë rol të rëndësishëm mësuesit në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?
8. Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm a luajnë rol kyç në motivimin e nxënësve në gjuhën shqipe?
9. Krijimi i një mjedisi inkurajues dhe mbështetës mund të ndikoj në motivimin e nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe?